

NDIKIMI I MENDIMIT SOCIAL SHQIPTAR NË KRIJIMIN E IDENTITETIT KOMBËTAR
(SAMI FRASHËRI, FAIK KONICA, BRANKO MERXHANI)

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

GRETA AVDYLI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

STUDIME PASUNIVERSITARE - MASTER

PRISHTINË
2021

NDIKIMI I MENDIMIT SOCIAL SHQIPTAR NË KRIJIMIN E IDENTITETIT
KOMBËTAR (SAMI FRASHËRI, FAIK KONICA, BRANKO MERXHANI)

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Berisha

Kandidatja: Greta Avdyli

Shqiptarët kanë qenë pre e pushtimeve të ndryshme, ku është tentuar të shtyhet identiteti, tradita dhe kultura shqiptare. Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte rezultat i rrethanave të krijuara nga pushtimi Osman. Kjo lëvizje politiko-sociale e kulturore u formua me qëllim të çlirimit nga pushtuesi, mbajtjes gjallë të ndjenjës së përkatësisë kombëtare si dhe krijimit të shtetit shqiptar. Kështu në shekullin XIX u shfaqën ideologët e parë iluministë të Rilindjes Kombëtare, me programin e tyre për arsimim dhe kultivim të letërsisë e kulturës shqiptare.

Mendimi social shqiptar ka qenë dhe padyshim gjithmonë do të mbetet strumbullari i idealeve për një komb shqiptar të emancipuar e të pavarur. Prandaj, në këtë punim diplome është trajtuar mendimi i asaj kohe me fokus në tre veprimtarë jashtëzakonisht të rëndësishëm për kulturën dhe historinë shqiptare: Sami Frashëri, Faik Konica dhe Branko Merxhani. Këta të tre vepruan në periudha dhe kontekste të ndryshme, prandaj studimi i secilit më vete është i rëndësishëm për shtjellimin e çështjes kombëtare.

Pavarësisht peripecive që karakterizuan historinë shqiptare nga nënshtrimi ndaj Perandorisë Osmane, revoltat, përpjekjet për të drejtat kombëtare dhe të shpërfaqjes kulturore, botimet dhe organet periodike të shtypit që trajtonin tema të karakterit nacional e që ngritën vetëdijen popullore por edhe rëndësinë e shqiptarëve në politikën e jashtme e deri tek shpallja e pavarësisë, ajo çka ka rëndësi të jashtëzakonshme është zelli për unifikim kombëtar dhe puna e pa ndalur mbi çështjen kombëtare. Përpjekjet e vazhdueshme, sidomos nën periudhën e opresionit janë tregues i qartë që shqiptarët ishin të aftë të përfaqësonin kombin e tyre.

Ky punim masteri përmban hyrjen, katër kapituj dhe konkluzionin

Në hyrje të këtij punimi janë shtjelluar në mënyrë të përgjithshme motivet për zgjedhjen e temës, metodat e studimit, si dhe çfarë rëndësie ka ky punim për literaturën shkencore dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kapitulli I – *Perceptimet teorike mbi kombin dhe nacionalizmin:* Ky kapitull përmban një trajtim të kornizave teorike mbi kombin dhe nacionalizmin në përgjithësi si dhe arsyen e ardhjes në skenë të mendimit iluminist shqiptar. Pra, janë shqyrtuar rrethanat të cilat bënë që mendimtarët të unifikohen për një kauzë të vetme, atë të çlirimit dhe zhvillimit të kulturës shqiptare. Këtu është analizuar konteksti i krijimit të kombit shqiptar dhe idealet e parashtruara nga figura të shquara të veprimtarëve shqiptarë. Përveç kësaj, në këtë kapitull është bërë një krahasim mes konceptimit të nacionalizmit shqiptar dhe shpërfaqjes së nacionalizmit në Evropë më 1848, rrjedhimisht periudhën e krijimit të shteteve-kombe.

Kapitulli II – *Sami Frashëri, Ideologu kryesor i lëvizjes kombëtare:* Ky kapitull fokusohet në veprimtarinë patriotike të Sami Frashërit si një ndër ideologët themelor në krijimin e identitetit kombëtar shqiptar. Ai ishte pjesë e *Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare*, pastaj ishte ndër dhjetë funksionarët e lartë shqiptarë i cili nënshkroi memorandumimin ku kërkohet që shqiptarëve t'u respektoheshin të drejtat, traditat e kultura. Kontributi i tij i pashoq shpërfaqet me punën e tij për konsolidimin e gjuhës shqipe, pra krijimin e alfabetit të përshtatshëm si dhe strukturimit të gramatikës. Sami Frashëri më të vëllain Naimin drejtonin *Shoqërinë e të shtypurit me shkronja shqip* me ç'rast hartonin tekstet shkollore. Poashtu ai drejtoi revistat e para në gjuhën shqipe *Drita* dhe *Dituria* ku aty botoi një numër artikujsh të cilat shtjellonin problematikat shqiptare. Samiu së bashku me vëllezërit e tij ishte lobues i pashoq i çështjes së kombit. Meqë ai ishte aktiv që nga 1872-1904, kapitulli i dytë fillon me të si paraprijës i dy veprimtarëve që do të trajtohen më vonë.

Kapitulli III – *Kontributi i Faik Konicës për kauzën e idealeve kombëtare:* Këtu trajtohet periudha kohore dhe rrethanat në të cilën dha kontributin e tij veprimtari Faik Konica. Prej 1897-1942 ai punoi pa reshtur për kauzën e idealeve kombëtare përmes posteve që gëzonte si anëtar i *Komisionit për Bashkimin e organizatave shqiptare në SHBA*, pastaj si një ndër themeluesit e *Federatës Pan-Shqiptare VATRA* e cila luajti rol të rëndësishëm për shqiptarët, si delegat në *Kongresin e Triestes* dhe si ministër në SHBA i emëruar nga Ahmet Zogu.

Përveç këtyre, Faik Konica ishte themelues i revistës *Albania* dhe kryeredaktori gazetës *Dielli*. Konica punoi në *Departamentin e Dorëshkrimeve në Muzeumin Britanik* ku studioi dokumente dhe dorëshkrime të cilat më vonë i botoi te revista *Albania* duke tentuar kështu t'i paraqesë botës një Shqipëri me karakter dhe kulturë të veçantë.

Kapitulli IV – Vizioni kombëtar i Branko Merxhanit dhe ideologjia e neo-shqiptarismës:

Në këtë kapitull shtjellohet periudha neo-shqiptare, ajo e Branko Merxhani-t i cili ishte aktiv që nga 1929, përmes shkrimeve të tij fillimisht në revistën *Demokratia*, pastaj themeloi revistën *Neo-shqiptarisma* e cila zgjati vetëm një muaj, shkroi artikuj tek *Illyria e Minerva*, si dhe botoi *Përpyjekjen Shqiptare*. Në këto revista e gazeta Merxhani me bashkëpunëtorët e tij përmes shkrimeve të tyre paraqitnin vizionin për sistemin neo-shqiptar, me të cilin synonin ta çonin çështjen e kombit përpara për të arritur në një pikë më të përparë me qytetërimin oksidental, por pa humbur vlerat që karakterizojnë kulturën shqiptare. Është shumë e rëndësishme të trajtohet zhvillimi i kombit shqiptar në periudhën e monarkisë dhe të analizohet përmbushja e kërkesave të rilindësve përmes punës së tyre.

Pyetjet hulumtuese:

- Çfarë ndikimi kishte mendimi social shqiptar në krijimin e identitetit kombëtar?
- Cili është kontributi i Sami Frashërit, Faik Konicës dhe Branko Merxhani-t në krijimin e identitetit kombëtar dhe në cilat lloje të nacionalizmit kontribuuan ata më së shumti?
- Cila është rëndësia e nacionalizmit për shqiptarët?

Metodologjia e punimit:

Në temën me titull “Ndikimi i mendimit social shqiptar në krijimin e identitetit kombëtar (Sami Frashëri, Faik Konica, Branko Merxhani)” si metodë kryesore është përdorur metoda analitike dhe leximi kritik i tekstit, i dokumenteve, fotografive, librave të autorëve dhe veprimtarëve të cilët kanë kontribuar për çështjen kombëtare. Poashtu është analizuar mendimi social për kohën, i cili ka qenë baza për unitet mes shqiptarëve. Përveç kësaj është shqyrtuar literatura e autorëve të huaj që kanë shkruar për shqiptarët, si dhe mbi konceptet e kombit dhe nacionalizmit. Kjo metodë është e rëndësishme pasi që plotëson hulumtimin përmes analizës së thellë të mendimit, shkrimeve e dokumenteve dhe ndihmon në paraqitjen e plotë të dokumentimit të historisë dhe nacionalizmit shqiptar.